

Organizata "Down Syndrome Kosova" ka organizuar takimin të rëndësishëm për një kategori njerëzish

Personat me sindromën

Down duhet trajtuar më mirë



MUSA MUSTAFA

MITROVICË, 29 TETOR - Personat e prekur nga sindroma Down, shoqëruar nga prindërit e tyre, janë mbledhur në Mitrovicë për të diskutuar për problemet dhe mënyrën se si të inkorporohen më lehtë në jetën e përditshme. Organizata "Down Syndrome Kosova" (OJQ DSK) ka organizuar takimin e prindërve të fëmijëve-personave të prekur me sindromën Down dhe me zyrtarë vendës e ndërkombëtarë. Drejtori ekzekutiv i organizatës nacionale "Down Syndrome Kosova", Driton Bajraktari, duke prezantuar arritjet në këta 18 muaj të themelimit të organizatës, ka theksuar:

"Mobilizimi i komunitetit të prekur me sindromën Down në Mitrovicë është prioritet dhe ka rëndësi të veçantë që këtyre personave t'u krijohet një perspektivë më e mirë për të ardhmen e

tyre". "Të jesh i prekur me sindromën Down, apo te jetoni me fëmijën-personin me këtë sindromë, duhet një punë më e madhe dhe për këtë duhet të ketë kujdes të shtuar edhe shoqëria dhe rrethi ku jetojnë këta persona", ka thënë Bajraktari. Përfaqësues të pushtetit lokal janë zotuar se së shpejti do t'i mundësohet OJQ-së DSK një hapësirë, ku do të zhvillojë aktivitetet në shërbim të komunitetit të prekur me këtë sindromë. Pjesëmarrësit, fëmijët me sindromën Down, prezantuar talentin e tyre përmes vallëzimit nën melodi të muzikës argëtuese, në restorantin "Carly". Në Komunën e Mitrovicës deri tash janë identifikuar 39 persona me sindromën Down, ndërsa takimi është organizuar edhe me përkrahjen e UNDP-së dhe organizatave të tjera humanitare.

Fotolajm